

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Njihet si “i tmerrshmi i Beratit”/ Si ra në prangat e policisë greke Lulzim Caka
ADRESA	https://lapsi.al/njihet-si-i-tmerrshmi-i-beratit-si-ra-ne-prangat-e-policise-greke-lulzim-caka-i1093588
BURIMI	lapsi.al
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 08:43:45 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 08:42:05 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	75aa0c0869e5b8554a4100d545f5e018a74db9723a80c18d5a57f4f62cab9420
TEKSTI	ec81d07cc740e5199fe21f0ce8ebd5fb488e71aab96a06456a926e14d7628176
PAMJA	b1fb2d5ee2ab2f9b10c82539fa7d5d19408831be3db31950514ff8ec2c61edc1

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	12bbce2b4d4d06100423b3a7b5ed69ded2b23c6427c88c38f06aca5a20c4f278
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	10ab5b8f79eea0a6c9439c21099c504de5d405b01d4b1e67f07490a5465dacd2
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/12bbce2b4d4d06100423b3a7b5ed69ded2b23c6427c88c38f06aca5a20c4f278>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Njihet si "i tmerrshmi i Beratit"/ Si ra në prangat e policisë greke Lulzim Caka

L LAPS1.AL • 13 SEPTEMBER 2026



Lulzim Caka është emri i personazhit misterioz të arrestuar nga policia greke si kreu i grupit kriminal shqiptar pas trafikut të 84 kg kokainë nga Kolumbia përmes kërcejve plastikë të trëndafilave. Caka i njohur ndryshe si "i tmerrshmi i Beratit", është arrestuar bashkë me të birin, në një vilë ku janë zbuluar 2 kg kokainë, kimikate e pajisje paketime të drogës, një pistoletë dhe një makinë luksoze.

Lulzim Caka rezulton person i shpallur në kërkim në Shqipëri, pasi është liruar në mënyrë të paligjshme nga burgu në vitin 2019, ku vuante dënim me 25 vjet burg për disa vrasje. Caka, i cili në Greqi njihet edhe me emrin e dytë John Franco, prej largimit nga Shqipëria jetonte në shtetin helen. Pikërisht në vitin 2022, Greqia ka refuzuar kërkesën e Shqipërisë për ekstradimin e Lulzim Cakës në Shqipëri.

Kush është Lulzim Caka

Lulzim Caka, është një nga krerët e bandave kriminale që ka vepruar gjatë viteve 1995-2000 në zonën e Beratit, Fierit dhe Lushnjës, i akuzuar për disa vrasje dhe i dënuar me 25-vite burg i është drejtuar për "prishje të vendimeve" Gjykatës Kushtetuese në dt. 19.12.2012, Gjykatës së Apelit në Vlorë në dt. 28.04.2015 dhe Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në vitin 2017.

Gjykata e Apelit Vlorë, në 19 Dhjetor të vitit 2012, e dënoi Cakën me 25 vjet heqje lirie për veprat penale të "vrasjes me dashje", "vrasjes në rrethana cilësuese, mbetur në tentativë" dhe "mbajtjes pa leje të armëve luftarake". Ngjarja për të cilën u dënua Caka ka ndodhur në muajin Mars të vitit 1998, ku Caka i ka bërë rezistencë forcave të policisë.

Ai u arrestua në Berat. Caka u kap i plagosur, ndërsa bashkëpunëtori i tij, Xhevahir Çela, mbeti i vrarë. Pas kësaj ngjarjeje, Lulzim Caka akuzoi shtetin që dha urdhër për eliminimin e tij, ndërsa nga hetimet rezultoi se Lulzim Caka i njohur ndryshe si "i forti" i Beratit kishte qëlluar edhe ndaj shokut të tij. Lulzim Caka do të mbahet mend për sfidat e tij ndaj drejtësisë shqiptare. Ai u arrestua dhe më pas u lirua për mungesë provash disa herë.

ide



Ortakut besprerë i Ron Yeffetit
Andi Bushati



Insistimi tek krimi, arësyeja përse kryeministri Rama duhet të dorëhiqet
Blendi Kajsiu

MOTITIRANA

24°C

KËMBIMIEURO

91.94

aktuale

15:53

Diaspora zbarkon në Tiranë për protestën e 105-të, shqiptarët udhëtojnë prej tri ditësh drejt kryeqytetit

22:36



PAMJET/ Mali i Zi nuk e lë karvanin e diasporës të futet në Shqipëri, i çon në Kosovë



TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndiqe Lapsin edhe në



Me interes nga publiku



Si arriti të fitonte lirinë Lulzim Caka?

Lulzim Caka i shpëtoi qëndrimit në qeli falë një mbrojtje të mirë që i është ofruar por edhe “ping-pongut” që bënë një sërë gjykatash, mes të cilave rrugën e lirisë ia hapi Gjykata e Lartë për rishikim vendimi, më tej Gjykata Kushtetuese dhe për “t”i vënë pulën” edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut.

Caka u soll në Shqipëri me një marrëveshje ekstradimi me Italinë në vitin 2003 dhe pas 16 viteve burgim atij iu konsideruan të shlyera 25 vitet e dënimit. Lirimi i Lulzim Cakës në korrik të vitit 2019 solli shkarkimin e drejtorit të burgut në Kosovë të Lushnjës dhe juristit të institucionit, ndërsa nisi një hetim për gjyqtarin që dha vendimin e lirimit të Lul Cakës. Ky i fundit u shpall sërish në kërkim policor me arsyen se lirimi i tij ishte bërë padrejtësisht dhe se duhet të kthehej në qeli për të shlyer vitet e dënimit.

Të këshilluara



Zgjedhjet në Suedi/ E djathta ekstreme synon pushtetin për herë të parë

Suedia do të mbajë zgjedhje të përgjithshme të dielën, të cilat ose do të rezultojnë në rikthimin në pus...



Breshëri plumbash ndaj një makine në Mat, autorët djegin automjetin e tyre

Policia e Matit njofton se në datë 12 shtator rreth orës 23:10, në fshatin Urakë, Njësia Administrative Rukaj, persona ende tës...



‘PISA 2025’: Pasqyra e deformuar e suksesit të qeverisë me arsimin



Pas pak mblidhet Kuvendi i Kosovës/ PDK refuzon ftesën e LVV: Shihemi në Kushtetuese!

Seanca konstituive e Kuvendit të Kosovës pritet të vazhdojë sot, ndërsa në rend të ditës është zgjedhja e n.s...



Të shtëna me armë zjarri në drejtim të një automjeti, gjendet e djegur edhe një makinë

Të shtëna me armë zjarri në drejtim të një automjeti, gjendet e djegur edhe një makinë



Gjyqtari i GJKKO: Rama mund të ketë përgjegjësi penale për mosekzekutimin e vendimit të pagave të magjistratëve




Kartoni i zi mbërrin në futboll, ja si funksionon: nuk do të përdoret për futbollistët




Qarkullonte me armë, arrestohet nipi i Lefter Kokës




E bujshme, Arteta e ka sabotuar qëllimisht Arsenal, duke shkaktuar edhe vonesa në fluturime: në Napoli funksionoi



Me sytë katër





16:47

A po eksporton apo jo armë Shqipëria? Ministria e Mbrojtjes me dy versione (VIDEO)

Që pas publikimit të përgjimeve të mikut izraelit të Ramës, Ron Yeffet, me disa shtetas ukrainas që kërkonin të bl...

"Plaka ime s'di pultin e TV dhe jo më e-Albania"/ Korreshi tallet në Komisionin e Ligjeve

21:56



PAMJET/ Zegjine Çausi ndryshon pamje, nuk e njohin Garda dhe gazetarët

21:21

VIDEO/ Batutat e Ramës me Altinin nga Peza: Ky nuk është socialist, por...

23:04



PAMJET/ Burri rreh një grua që në takimin e dytë sepse ajo e refuzoi

28:31

SPORT

→ Të tjerë artikuj



10:36

Tenistja ukrainase, Yastremska rrëfen e tronditur: "Një raketë ruse ma shkatërroi shtëpinë"



10:31

Mammana përplasat nga portieri: brinjë të thyera dhe mushkëri e shpuar, operohet me urgjencë



09:45

Gafa skandaloze e Estupiñán dhe përplasja e De Winter me Gila: mbrojtja e Amorim e turpshme



09:38

E morën para ndeshjes, Matias Pourrain rrëfen arrestimin nga ICE: "Pa ushqim, ujë me urinë, nuk e dija ku isha"



28:32

Polemika në Niko Dovana, dritat fiken sërisht para penaltisë: Teuta merr kreun, Vora zhytet më tej në krizë



28:22

Moreira shpëton Amorim me një dygolësh: gafat vendosën në barazimin spektakolar mes Lazios e Milan



18:33

E shtunë e komplikuar për gjigantët e Premier League: Chelsea ndalet nga Hull City, tjetër gabim i Liverpool

PAPARAZZI



22:09

Tension në tapetin e kuq? Reagimi i Nicola Peltz ndaj Brooklyn Beckham bëhet viral

Brooklyn Beckham dhe bashkëshortja e tij, Nicola Peltz, janë bërë qendër të...



Megan Thee Stallion flet për ndarjen nga Klay Thompson

21:27



Travis Kelce flet për herë të parë për dasmën me Taylor Swift: "Ishte magjike"

21:24



Shkruan: 20:23
vëmendjes mediatike, pas një momenti t...

Misteri i James Bond-it të ri po merr
fund? Skenaristi zbulon detajin e papritur

20:23

Cassie Ventura shfaqet për herë të parë
në tapetin e kuq pas gjyqit të Diddy-t

18:56

Lapsi



Lajme Sport Paparazzi Stil Planet Leaks Dossier Blog Lapsi Video

Na ndiq

Themelues
Armand Shkullaku
Andi Bushati

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.